



MINISTRIA E DREJTËSISË

DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

**ANALIZË STATISTIKORE
NDIHMA JURIDIKE E GARANTUAR NGA SHTETI**

Të dhëna statistikore mbi ndihmën juridike parësore dhe dytësore

TETOR 2022

DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

Botim i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas

© Ndalohet çdo prodhim, riprodhim, shitje, rishitje, shpërndarje, kopjim, fotokopjim, përkthim, përshtatje, huapërdorje, shfrytëzim, transmetim, regjistrim, ruajtje, depozitim, përdorje dhe/ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, si dhe çdo veprim cenues me çfarëdo lloj mjete apo formë

Tabela e përmbajtjes

H Y R J E.....	3
KREU I- Të dhëna statistikore mbi çështjet me objekt ndihmën juridike parësore	6
Të dhëna statistikore mbi rastet e raportuara nga qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore	6
Të dhëna statistikore mbi rastet e raportuara nga organizatat jofitimprurëse të autorizuar	15
Të dhëna statistikore mbi rastet e raportuara nga Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve.....	23
Të dhëna statistikore mbi rastet e raportuara nga platforma Juristionline dhe Numri i Gjellbër 08001010	25
Numri i Gjellbër 08001010	25
Të dhëna statistikore mbi numrin e rasteve të raportuara nga çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike parësore	26
Të dhëna statistikore mbi numrin e rasteve të trajtuara nga çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike parësore (sipas natyrës së çështjes)	28
Të dhëna statistikore mbi numrin e rasteve të trajtuara nga çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike parësore (sipas kategorisë përfituese).....	29
KREU 2: TË DHËNA STATISTIKORE MBI ÇËSHTJET ME OBJEKT NDIHMËN JURIDIKE DYTËSORE.....	31
Të dhëna statistikore: Kategoria Femra / Meshkuj.....	31
Të dhëna statistikore: Kategoria përfituese me të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme / kategori e veçantë.	32
Të dhëna statistikore: Lloji i ndihmës dytësore të ofruar.	32
Të dhëna statistikore: Vendimi i Gjykatës / Organit procedues.	33
Të dhëna statistikore: Lloji i çështjes për të cilën kërkohet ndihmë juridike.	33
Të dhëna statistikore: Gjykata që ka dhënë vendimin.	34
KONKLUSIONE	34
Sa i përket ndihmës juridike parësore	36
Sa i përket ndihmës juridike dytësore.....	37
Numri i vendimeve gjyqesore të ankimuara nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas.....	38
Ankimet e pranuar nga gjykatat e apelit (civil, administrativ) sipas juridiksionit	38
Kërkesat për ndihmë juridike dytësore të rrëzuara apo të pushuara nga gjykata	38

Kërkesa për ndreqje gabimi të depozituara në gjykatë.....	38
Kërkesa për ndreqje gabimi të pranuar nga gjykata.....	38
Numri i dosjeve avokatëve/ekspertëve të pranuar për ekzekutim pagese	39
Numri i dosjeve avokatëve/ekspertëve të refuzuara për ekzekutim pagese	39
Informacion mbi pagesat e përfaqësimit të avokatëve të ndihmës juridike dytësore si dhe shpenzimet gjyqësore të likujduara.....	40
NDIHMA JURIDIKE PARËSORE JANAR- TETOR 2022	41
NDIHMA JURIDIKE DYTËSORE JANAR- TETOR 2022.....	42

HYRJE

Qëllimi i këtij punimi është krijimi i një analize statistikore të unifikuar sa i përket sistemit të ndihmës juridike ashtu si kërkohet shprehimisht në ligjin nr. 111/2017, **“Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”** dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij e *cila ndikon drejtpërdrejt në hartimin dhe zbatimin e politikave të mëtejshme në fushën e ndihmës juridike falas nga Ministri i Drejtësisë.*

Referuar shkronjës “d”, neni 8 i Ligjit nr.111/2017, Drejtoria e Ndihmës Juridike, mbledh dhe analizon informacionin mbi dhënien e ndihmës juridike për të përmirësuar funksionimin e sistemit të ofrimit të ndihmës juridike dhe organizon fushata për rritjen e ndërgjegjësimit publik mbi ofrimin e ndihmës juridike dhe kushtet për përfitim e saj.

Gjithashtu, referuar shkronjës “gj”, neni 8 i Ligjit nr.111/2017, **Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas mban, mbledh, plotëson dhe administron të dhënat e regjistrit të kërkesave dhe vetëdeklarimeve të subjekteve të këtij ligji dhe të dhënat e regjistrit të organizatave jofitimprurëse që ofrojnë ndihmë juridike parësore, sipas rregullave dhe procedurave të miratuara nga Ministri i Drejtësisë.**

Procedura e mbajtjes, mbledhjes, plotësimit si dhe administrimit të këtyre të dhënave është e përcaktuar shprehimisht në udhëzimin nr. 1, datë 08.03.2019, **“Për miratimin e rregullave dhe procedurave për mbledhjen, plotësimin dhe administrimin e të dhënave të regjistrave”.**

Referuar këtij udhëzimi, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas është organi përgjegjës për mbajtjen, mbledhjen, plotësimin dhe administrimin e:

a) Të dhënave të regjistrit të kërkesave dhe vetëdeklarimeve të subjekteve përfituese të ndihmës juridike të garantuar nga shteti.

Të dhënat e regjistrit të kërkesave dhe vetëdeklarimeve të subjekteve përfituese të ndihmës juridike të garantuar nga shteti mbledhen në bazë të kërkesës për ndihmë juridike, vetëdeklarimit dhe çdo dokumentacioni tjetër të depozituar nga kërkuesi për këtë qëllim.

Në regjistrin e kërkesave dhe vetëdeklarimeve për ndihmë juridike parësore dhe dytësore, për çdo kërkues, përfshihen të dhënat e mëposhtme:

- Kërkuesi (Emri, Mbiemri);
- Gjinia,
- Datëlindja,
- Shtetësia,
- Gjendja familjare (numri i pjesëtarëve në familje),
- Gjendja e punësimit,
- Adresa dhe të dhëna të tjera kontakti,
- Gjykata/Organi procedues pranë të cilit është dorëzuar kërkesa;
- Lloji i vetëdeklarimit;
- Lloji i ndihmës dytësore të kërkuar;
- Çështje juridike;
- Vendimi i gjykatës/organit procedues mbi kërkesën për ndihmë juridike;
- Data/Nr. i vendimit;
- Ankimim i vendimit;
- Pala ankimuese;
- Vendimi mbi ankimin;
- Avokati i caktuar;
- Pagesat e përfituara nga avokati;
- Rimbursimi i pagesave.

Udhëzimi parashikon se regjistri i kërkesave dhe vetëdeklarimeve të subjekteve përfituese mbahet në formë elektronike dhe bëhen publike nëpërmjet faqes elektronike të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Regjistrat me të dhënat e plota, sipas këtij udhëzimi, mbahen pranë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas. Të dhënat e plota të regjistrave u vihen në dispozicion institucioneve të drejtësisë dhe palëve të interesuara, pasi vlerësohet qëllimi i kërkesës dhe në përputhje me kriteret dhe kufizimet e parashikuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Punonjësi i autorizuar nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas

Drejtorja e Ndihmës Juridike Falas autorizon me shkrim punonjës për plotësimin dhe përditësimin e regjistrave. Punonjësi i autorizuar është përgjegjës për saktësinë dhe përditësimin e të dhënave të hedhura prej tij.

Gjithashtu, udhëzimi parashikon se punonjësi i autorizuar nuk mund të ndërhyjë dhe të ndryshojë rubrikat e regjistrave. Në rast se bëhen gabime materiale në hedhjen e informacionit në regjistër, punonjësi i autorizuar bën korrigjimin dhe shkruan informacionin e saktë. Regjistrat administrohen nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas dhe për ruajtjen dhe asgjësimin e tyre zbatohen rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për arkivat.

KREU I- Të dhëna statistikore mbi çështjet me objekt ndihmën juridike parësore

Të dhëna statistikore mbi rastet e raportuara nga qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore

Referuar nenit 13 të ligjit 111/2017, Ndihma juridike parësore jepet nga: ***Qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore (përmes punonjësve me trajnim të posaçëm); Organizatat jofitimprurëse të autorizuara dhe Klinikat ligjore pranë institucioneve të arsimit të lartë.***

Qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore janë njësi të specializuara për dhënien e ndihmës juridike parësore. Që prej hyrjes në fuqi të ligjit nr. 111/2017, Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë kanë patur për qëllim kryesor evidentimin dhe hapjen e qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore në ato qytete ku shërbimi i ndihmës juridike falas (ofruar në mënyrë autonome nga ana e organizatave të ndryshme joqeveritare) ishte i mangët ose inekzistent por nga ana tjetër, edhe nevojat e qytetarëve për ndihmë juridike falas ishin të mëdha.

Aktualisht, gjatë periudhës Tetor 2022, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas administron 12 (dymbëdhjetë) qendra të shërbimit të ndihmës juridike parësore si vijon:

- ❖ **Tiranë** (me buxhetin e shtetit);
- ❖ **Durrës** (me buxhetin e shtetit);
- ❖ **Lezhë** (në bashkëpunim me UNDP në kuadër të projektit: “Mbi zgjerimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për gratë dhe burrat në Shqipëri”);
- ❖ **Pogradec** (në bashkëpunim me UNDP në kuadër të projektit: “Mbi zgjerimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për gratë dhe burrat në Shqipëri”);
- ❖ **Lushnje** (me buxhetin e shtetit);
- ❖ **Shkodër** (me buxhetin e shtetit);
- ❖ **Gjirokastrë** (në bashkëpunim me UNDP në kuadër të projektit: “Mbi zgjerimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për gratë dhe burrat në Shqipëri”);
- ❖ **Fier** (në bashkëpunim me UNDP në kuadër të projektit: “Mbi zgjerimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për gratë dhe burrat në Shqipëri”);
- ❖ **Dibër** (në bashkëpunim me UNDP në kuadër të projektit: “Mbi zgjerimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për gratë dhe burrat në Shqipëri”);
- ❖ **Vlorë** (në bashkëpunim me UNDP në kuadër të projektit: “Mbi zgjerimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për gratë dhe burrat në Shqipëri”);
- ❖ **Elbasan** (në bashkëpunim me UNDP në kuadër të projektit: “Mbi zgjerimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për gratë dhe burrat në Shqipëri”);
- ❖ **Berat** (në bashkëpunim me UNDP në kuadër të projektit: “Mbi zgjerimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për gratë dhe burrat në Shqipëri”).

Harta e Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore

Shkodër

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër

Lezhë

- Bashkia Lezhë

Durrës

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës

Tiranë

- Ministria e Drejtësisë

Fier

- Këshilli i Qarkut Fier

Vlorë

- Bashkia Vlorë

Dibër

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër

Elbasan

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan

Berat

- Bashkia Berat

Lushnje

- Bashkia Lushnje

Pogradec

- Biblioteka "Mitrush Kuteli", Pogradec

Gjirokastrë

- Pallati i Sportit, Gjirokastrë




Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore	Totali i Rasteve të raportuara	Moshë		Gjinia		Shtetësia		Kategoritë përfituese (Specifiko Kategorinë)			Natyra e Çështjes			Përkatësia Etnike	Viktima Dhune
		Mitur	Rritur	Femër	Mashkull	Shqiptar	I huaj	Të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme	Kategori e Veçantë	Papërcaktuar	Civile	Penale	Administrative		
Tiranë	46	-	46	34	12	46	-	34	12 (5 viktima dhune, 5 aftësi e kufizuar, 2 trajtim i pavullnetshëm në institucione të shëndetit mendor)	-	28	4	14	-	5
Lezhë	27	-	27	13	14	27	-	24	3 (1 viktimë dhune, 1 aftësi e kufizuar, 1 ndihmë ekonomike)	-	14	-	13	5	1
Durrës	26	-	26	20	6	26	-	20	6 (4 viktima dhune, 1 aftësi e kufizuar, 1 ndihmë ekonomike)	-	21	2	3	-	4
Lushnje	18	-	18	11	7	18	-	14	4 (1 viktimë dhune, 1 KMCAP, 2 ndihmë ekonomike)	-	17	1	-	2	1
Shkodër	30	-	30	17	13	30	-	23	7 (2 viktimë dhune, 1 ndihmë ekonomike, 3 KMCAP, 1 skema e mbrojtjes sociale)	-	22	2	6	3	2
Gjirokastrë	38	-	38	23	15	38	-	14	24 (16 skema e mbrojtjes sociale, 4 aftësi	-	9	1	28	9	4


									<i>e kufizuar, 4 viktimë dhune)</i>						
Pogradec	21	-	21	12	9	21	-	17	<i>4 (1 KMCAP, 1 aftësi e kufizuar, 1 ndihmë ekonomike, 1 skema e mbrojtjes sociale)</i>	-	8	1	12	1	-
Fier	31	-	31	16	15	31	-	25	<i>6(2 viktima dhune, 1 skema e mbrojtjes sociale, 1 viktimë diskriminimi, 2 aftësi e kufizuar)</i>	-	4	3	24	2	2
Dibër	6	-	6	2	4	6	-	3	<i>3 (1 KMCAP, 2 skema e mbrojtjes sociale)</i>	-	4	-	2	1	-
Vlorë	30	-	30	18	12	30	-	22	<i>8 (5 aftësi e kufizuar, 1 viktimë dhune, 2 skema e mbrojtjes sociale)</i>	-	8	1	21	2	1
Elbasan	14	-	14	6	8	14	-	1	<i>13(7 aftësi e kufizuar, 3 pensionistë, 2 skema e mbrojtjes sociale, 1 ndihmë ekonomike)</i>	-	2	3	9	1	-
Berat	15	-	15	6	9	15	-	11	<i>4 (3pensionistë, 1 viktimë dhune)</i>	-	2	-	13	3	1
TOTALI	302	-	302	178	124	302	-	208	94	-	139	18	145	29	21

Për muajin Tetor 2022 janë administruar 302 raste nga Qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore


Rastet për muajin Tetor Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore




Rastet e raportuara nga Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore sipas natyrës së çështjes




Numri i subjekteve përfitues sipas kategorive përfituese të përcaktuara në ligj



Numri i rasteve të raportuara sipas gjinisë



Të dhëna specifike mbi kategoritë përfituese të ndihmës juridike parësore



■ Viktimë dhune
■ KMCAP
■ Skema e mbrojtjes sociale
■ Romë/egjiptiane

■ Aftësi e kufizuar
■ Ndihmë ekonomike
■ Trajtim i pavullnetshëm në institucione të shëndetit mendor
■ Pensionistë

Të dhëna statistikore mbi rastet e raportuara nga organizatat jofitimprurëse të autorizuara

Referuar nenit 15 të ligjit 111/2017, Organizatat jofitimprurëse japin shërbime të ndihmës juridike parësore në përputhje me autorizimin e miratuar nga Ministri i Drejtësisë. Procedurat dhe dokumentacioni për autorizimin e tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Procedura e dhënies të autorizimeve për periudhën 2022-2024, ka përfunduar më datë 27.09.2022, përmes lëshimit të Urdhrave të Ministrit të Drejtësisë për 15 (pesëmbëdhjetë) organizata jofitimprurëse, si vijon:

- **Forumi i Gruas Elbasan (FGE)**, Dr. Ekzekutiv: Zj.Shpresa Banja. ·
- **Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri (CRCA)**, Dr. Ekzekutiv: Z.Altin Hazizaj
- **Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNL)**, Dr. Ekzekutiv: Zj.Aurela Bozo.
- **Qendra Psiko-Sociale Vatra**, Dr. Ekzekutiv: Zj.Brikena Puka
- **Qendra e Gruas Hapa të Lehtë**, Dr. Ekzekutiv: Zj.Denada Shpuza.
- **Qendra ALTRI**, Dr. Ekzekutiv: Zj.Eda Noçka.
- **Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza**, Dr. Ekzekutiv: Zj.Iris Luarasi
- **Shoqata “Mbrojtja e të Drejtave të Gruas Fshatare dhe Qytetare Berat”**, Dr. Ekzekutiv: Zj.Artë Dyrmishi
- **Shoqata “Shërbimet shqiptare për refugjatët dhe migrantët”**, Dr. Ekzekutiv: Zj.Mariana Hereni
- **Organizata “Refleksione”**, Dr. Ekzekutiv: Zj.Anthulla Ruçi.
- **Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin**, Dr. Ekzekutiv: Zj. Elona Hoxha.
- **Qendra “Konsumatori Shqiptar”**, Dr. Ekzekutiv: Zj.Ersida Teliti.
- **Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara**, Dr. Ekzekutiv: Zj. Anjeza Puka.
- **Organizata “Të ndryshëm dhe të barabartë”**, Dr. Ekzekutiv: Zj. Marjana Meshi.
- **Organizata “Shërbimi ligjor falas Tiranë”**, Dr. Ekzekutiv: Zj. Rajmonda Bozo.

OJF e Autorizuar	Totali i Rasteve	Mosha		Gjinia		Shtetësia			Kategoritë përfituese (Specifiko Kategorinë)			Natyra e çështjes		
		Mitur	Rritur	F	M	Shqiptar	I huaj	Pa shtetësi	Të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme	Kategori e Veçantë	Papërcaktuar	Civile	Penale	Admin
“Qendra e Këshillimit për Gra dhe Vajza”	5	0	5	5	0	5	0	0	4	1(viktimë e dhunës në familje)	0	5	0	0
“Mbrojtja e të drejtave të gruas qytetare dhe fshatare Berat”	5	0	5	3	2	5	0	0	0	0	5	1	0	4
“Qendra e shërbimeve dhe praktikave ligjore të integruara”	20	1	19	8	12	20	0	0	20	0	0	5	2	13
“Qendra Vatra”	42	4	38	42	0	42	0	0	0	42 (35 viktima të dhunës në familje; 1 i mitur në konflikt me ligjin; 6 viktima të trafikimit ose viktima të mundshme të trafikimit; 1 përfitues nga skemat e mbrojtjes sociale)	0	39	3	0
CRCA	31	12	19	23	8	30	1	0	0	10 (3 viktima të dhunës në familje; 1 i mitur në konflikt me ligjin; 6 viktima të abuzimit seksual/psikologjik; 0	21	20	11	0


											<i>viktima të bullizmit kibernetik)</i>				
“Forumi i Gruas Elbasan”	13	0	13	13	0	13	0	0	0	0	0	13	13	0	0
“Shërbimi Ligjor Falas (TLAS)”	85	27	58	57	28	59	1	25	85	0	0	0	0	0	85
“Të ndryshëm dhe të barabartë”	20	1	19	20	0	20	0	0	0	20 (10 viktima të dhunës në familje; 7 viktima të trafikimit ose viktima të mundshme të trafikimit; 2 viktima të abuzimit seksual; 1 KMCAP)	0	13	3	4	
“Albanian Legal and Territorial Institute (ALTRI)”	23	0	23	12	11	23	0	0	0	1 (1 përfitues nga skemat e mbrojtjes sociale)	22	10	1	12	
“Qendra për nisma ligjore qytetare”	48	0	48	43	5	48	0	0	29	19 (19 viktima të dhunës në familje; 0 viktima të veprave të turpshme; 0 përfitues nga skemat e mbrojtjes sociale)	0	32	5	11	
“Shërbimet shqiptare për refugjatët dhe migrantët”	10	0	10	4	6	0	10	0	0	0	10	0	0	0	10
“Qendra Konsumatori Shqiptar”	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
QSHPHZ	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

Qendra e Gruas “Hapa të lehtë”	12	0	12	12	0	12	0	0	11	1 (KMCAP)	0	11	1	0
Organizata “Refleksione”	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
TOTAL¹	314	45	269	242	72	277	12	25	149	94	71	149	26	139


Për muajin Tetor 2022 janë administruar 314 raste nga OJF e autorizuara

¹ **5 Egjiptianë dhe 3 Romë** kanë përfituar nga shërbimi i ndihmës juridike parësore nga organizatat jofitimprurëse të autorizuara për muajin **Tetor 2022**;
2 të mitur në konflikt me ligjin dhe 45 të mitur kanë përfituar nga shërbimi i ndihmës juridike parësore nga organizatat jofitimprurëse të autorizuara për muajin **Tetort 2022**.


Numri i rasteve të raportuara nga OJF e autorizuar




Numri i rasteve të raportuara sipas natyrës së çështjes



Numri i rasteve të raportuara sipas gjinisë




Numri i subjekteve përfitues sipas kategorive të përcaktuara në ligj



■ Me të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme ■ Kategori të Veçanta ■ Të paidentifikuar

Të dhëna specifike mbi kategoritë përfituese të ndihmës juridike parësore



Të dhëna statistikore mbi rastet e raportuara nga Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve

Një ndër ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore janë edhe **Klinikat e Ligjit**. Bazuar në nenin 16 të ligjit nr. 111/2017, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas bashkëpunon me klinikat ligjore, sipas kushteve dhe kriterëve të parashikuara në marrëveshjet përkatëse të bashkëpunimit për trajnimin dhe përditësimin e njohurive të studentëve të përfshirë pranë këtyre klinikave, mbi çështjet e lidhura me ndihmën juridike parësore

Aktualisht Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka lidhur marrëveshje me 12 Institucione të Arsimit të Lartë, në Tiranë, Durrës, Shkodër dhe Vlorë, konkretisht:

1. Fakulteti i Drejtësisë;
2. Kolegji Universitar “Wisdom”;
3. Klinika e Ligjit Shkodër;
4. Universiteti “Aleksandër Mojsiu” Durrës;
5. Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë;
6. “Universiteti European i Tiranës”;
7. “Universiteti “Qirjazi”
8. Universiteti “Bedër”
9. Universiteti “Mesdhetar”
10. Universiteti “Marin Barleti”
11. Universiteti “Luarasi”
12. Universiteti “Epoka”.

Referuar nenit 7 të marrëveshjeve Tip të bashkëpunimit: Klinikat Ligjore do të dëgojnë të dhëna periodike çdo muaj pranë Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas mbi personat të cilët kanë aplikuar/përfutuar ndihmë juridike parësore. Të dhënat do të dërgohen brenda 5(pesë) ditëve të para të muajit pasardhës të muajit referues. Këto institucione kanë vendosur në dispozicion të qytetarëve zyra të brendshme të përshtatshme për pritjen e klientëve, të aksesueshme edhe nga persona me aftësi të kufizuara. Klinikat, referuar marrëveshjes së bashkëpunimit do të ofrojnë shërbimin e ndihmës juridike parësore sipas standardeve të përcaktuara nga Ministri i Drejtësisë dhe së bashku me qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe organizatat jofitimprurëse të autorizuara do të ofrojnë ndihmë juridike parësore falas për çdo subjekt përfitues sipas përcaktimeve të ligjit nr. 111/2017.

Për muajin Tetor janë administruar 0 raste nga Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve

Klinikat e ligjit	Totali i Rasteve të trajtuara	Mosha		Gjinia		Shtetësia		Kategoritë përfituese (Specifiko Kategorinë)			Natyra e Cështjes			Përkatësia Etnike	Viktima dhune
		Mitur	Rritur	Femër	Mashkull	Shqiptar	I huaj	Të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme	Kategori e Vecantë	Papërcaktuar	Civile	Penale	Administrative		
Kolegji Universitar Ësdom	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti Aleksandër Moisiu Durrës	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Kolegji universitar Bedër	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Kolegji Universitar Qiriazi	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti Mesdhetar	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti Europjan i Tiranës	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Fakulteti i Drejtësisë, UT	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti Ismail Qemali Vlorë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Klinika e ligjit në Shkodër	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti “Marin Barleti”	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti “Epoka”	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
TOTALI	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-

Të dhëna statistikore mbi rastet e raportuara nga platforma Juristionline dhe Numri i Gjelbër 08001010

Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Fondacionin Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, për të garantuar aksesin e qytetarëve nëpërmjet ndihmës juridike falas, ka mundur për të gjithë qytetarët ofrimin e shërbimeve ligjore online përmes **platformës juristionline.al**. Përmes kësaj platforme çdo qytetar ka mundësi të këshillohet dhe informohet lidhur me aktet normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit dhe metodat për ushtrimin e këtyre të drejtave në procesin gjyqësor dhe në atë jashtëgjyqësor, dhënien e ndihmës në hartimin dhe përpilimin e dokumenteve të nevojshme për të vënë në lëvizje administratën shtetërore ose për të kërkuar ndihmë juridike dytësore.

Pyetjet e dërguara në këtë platformë, që nga fillimi i funksionimit të saj, kanë qenë të shumëllojshme duke theksuar edhe njëherë nevojën që kanë patur qytetarët për një sistem të tillë i cili deri më tani figuron të jetë mjaft rezultativ sidomos në kushtet kur në vend filloi ndërmarrja e masave kufizuese si pasojë e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga virusi (Covid-19).

Kjo platformë ka rezultuar mjaft e suksesshme pasi vihet re një numër i konsiderueshëm qytetarësh të cilët i janë drejtuar me qëllim marrjen e një orientimi ligjor mbi problematikat e tyre edhe pas përfundimit të gjendjes së fatkeqësisë natyrore. ***Duke marrë në konsideratë natyrën e këtij shërbimi dhe duke qenë se qytetarët mund të parashtrojnë problematikën e tyre në këtë platformë thjesht përmes adresimit të një pyetjeje, pa qenë nevoja për të plotësuar të dhëna shtesë të përcaktuara në formularët për përfitimin e ndihmës juridike parësore, të dhënat statistikore që mund të pasqyrojnë përkojnë vetëm me natyrën e çështjes (civile/penale apo administrative)***

RASTET E TRAJTUARA TETOR 2022 115

Civile: 42 pyetje Administrative: 52 pyetje Penale: 11 pyetje Informacion mbi ligje specifike: 10 pyetje


Numri i Gjelbër 08001010

Në funksion të masave të shtuara, të ndërmarrura për qytetarët që kanë nevojë për shërbime të ndihmës juridike parësore, Ministria ka vendosur në dispozicion një linjë të gjelbër në të cilën kanë akses falas të gjithë qytetarët për shërbime të ndihmës juridike. Vendosja e një numri falas është një garanci më shumë për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike falas duke siguruar për qytetarët disponibilitet në çdo kohë dhe përmes disa formave. ***Si platforma juristionline ashtu edhe linja e gjelbër janë masa të shtuara duke garantuar shërbime profesionale dhe me standard të lartë dhe duke qenë sa më pranë qytetarit. Nga të dhënat e administruara nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas rezulton se qytetarët kanë shfaqur mjaft interes në përfitimin e këtij shërbimi ligjor gjë që përbën një hap mjaft pozitiv në kuadër të garantimit të aksesit në drejtësi për qytetarët.***


NUMRI I RASTEVE TË TRAJTUARA (Numri i gjelbër 08001010)

TOTALI I RASTEVE (Telefonatave) 49


Të dhëna statistikore mbi numrin e rasteve të raportuara nga çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike parësore




Të dhëna statistikore mbi numrin e rasteve të raportuara nga çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike parësore (sipas gjinisë)



**Të dhëna statistikore mbi numrin e rasteve të trajtuara nga çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike parësore
(sipas natyrës së çështjes)**




**Të dhëna statistikore mbi numrin e rasteve të trajtuara nga çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike parësore
(sipas kategorisë përfituese)**



Totali i rasteve të trajtuara nga ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore për muajin Tetor 2022

780 raste



KREU 2: TË DHËNA STATISTIKORE MBI ÇËSHTJET ME OBJEKT NDIHMËN JURIDIKE DYTËSORE

1. Të dhëna statistikore: Sipas ndarjes gjinore, Gra dhe Burra.

Nga të dhënat e administruara nga DNJF gjatë muajit Tetor 2022, rezulton se për **72 vendime gjyqësore** në total me objekt kërkesën e ndihmës juridike falas, **43** prej tyre rezultojnë për kërkuese gra, dhe **29** prej tyre për kërkuese burra. Këto të dhëna paraqiten në formë tabelare si vijon:

Të dhëna statistikore mbi kërkuetit sipas ndarjes gjinore, Gra dhe Burra TETOR 2022		
<i>Kategoria Gra / Burra</i>	<i>Numri i kërkuetve</i>	<i>Komente / të tjera</i>
Kërkuese Gra	43	<i>Në vijimësi të trendit të zakonshëm, kërkuetit e ndihmës juridike falas për muajin Tetor 2022 janë më shumë gra se kërkuetit burra.</i>
Kërkuese Burra	29	
<u>TOTALI = 72 Vendime Gjyqësore</u>		

2. Të dhëna statistikore: Sipas kategorive përfituese, me të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme / kategori e veçantë.

Nga të dhënat e administruara nga DNJF gjatë muajit Tetor 2022, rezulton se nga **72 vendime gjyqësore** në total me objekt kërkesën e ndihmës juridike, **48** prej tyre rezultojnë për kërkuese që pretendojnë se i përkasin kategorisë së personave me pasuri dhe të ardhura të pamjaftueshme, **22** prej tyre rezultojnë nga kërkuese që bëjnë pjesë në kategoritë e veçanta sipas ligjit, dhe **2** prej tyre të pa specifikuar në vendimin gjyqësor.

Këto të dhëna paraqiten në formë tabelare si vijon:

Të dhëna statistikore mbi kërkuesit sipas kategorive përfituese TETOR 2022			
Kategoria përfituese		Numri i kërkuesve	Komente / të tjera
Të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme		48	1. Në vijimësi të trendit të zakonshëm, kërkuesit e ndihmës juridike falas për muajin Tetor 2022 janë më shumë qytetarë që pretendojnë të jenë në kushtet e kategorisë së personave me pasuri dhe të ardhura të pamjaftueshme. 2. Ndërmjet kategorive të veçanta, numrin më lartë e kanë personat me status viktimë dhune/diskriminimi.
E pa specifikuar në vendimin gjyqësor		2	
Kategori e veçantë	Viktimë dhune / diskriminimi	12	
	Person me aftësi ndryshe / statusi i të verbërit	8	
(Total 22)	Përfitues nga skema e mbrojtjes sociale	2	
	Komuniteti Rom	0	
	Statusi Jetim	0	
TOTALI = 72 Vendime Gjyqësore			

3. Të dhëna statistikore: Lloji i ndihmës dytësore të kërkuar nga qytetarët.

Nga të dhënat e administruara nga DNJF gjatë muajit Tetor 2022, rezulton se nga **72 vendime** gjyqësore në total me objekt kërkesën e ndihmës juridike, **6** prej tyre janë kërkesa për dhënien e ndihmës juridike dytësore me avokat, **53** prej tyre janë kërkesa për dhënien e ndihmës juridike dytësore dhe përjashtimin nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore dhe **13** prej tyre janë kërkesa për përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore. Këto të dhëna paraqiten në formë tabelare si vijon:

Të dhëna statistikore mbi llojin e ndihmës dytësore të kërkuar TETOR 2022		
Lloji i ndihmës dytësore të ofruar	Numri i Përfituesve	Komente / të tjera
Ndihmë juridike dytësore me avokat	6	Në analizë të së tërës, shihet që në pjesën më të madhe, kërkuesit kërkojnë ndihmën juridike dytësore dhe përjashtimin nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore.
Ndihmë juridike dytësore dhe përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore	53	
Përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore	13	
TOTALI = 72 Vendime Gjyqësore		

4. Të dhëna statistikore: Sipas vendimmarrjes së Gjykatave / Organit procedues për kërkesat.

Nga të dhënat e administruara nga DNJF gjatë muajit Tetor 2022, nga **72 vendime gjyqësore** në total me objekt kërkesën e ndihmës juridike, rezulton se janë pranuar **67** kërkesa për ndihmë juridike dytësore dhe/ose përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore ,janë rrëzuar **3** kërkesa për përfitim nga ndihma juridike dytësore dhe/ose përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore, si dhe është pushuar **2** kërkesa për përfitim nga ndihma juridike dytësore dhe/ose përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore.

Këto të dhëna paraqiten në formë tabelare si vijon:

Të dhëna statistikore vendimmarrjes së gjykatave ose organit procedues TETOR 2022			
<i>Lloji i ndihmës dytësore të ofruar</i>	<i>Vendimi i Gjykatës / Organit Procedues Pranim / rrëzim pranim pjesërisht</i>	<i>Numri i Kërkuesve</i>	<i>Komente / të tjera</i>
Ndihmë juridike dytësore përfaqësim me avokat	Pranuar	6	1. Në vijimësi të trendit të zakonshëm evidentohet një numër i ulët i vendimeve që rrëzojnë kërkesën e ndihmës juridike. 2. Në analizë të së tërësi, nuk evidentohet raport i caktuar ndërmjet refuzimeve përsa i përket llojit të ndihmës juridike.
	Rrëzuar	0	
Ndihmë juridike dytësore dhe përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore	Pushuar Çështja	0	
	Pranuar	48	
Përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore	Rrëzuar	3	
	Pushuar Çështja	2	
Përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore	Prishje vendimesh	0	
	Pranuar	13	
	Rrëzuar	0	
<u>TOTALI = 72 Vendime Gjyqësore</u>			

5. Të dhëna statistikore: Lloji i çështjes për të cilën kërkohet ndihmë juridike.

Nga të dhënat e administruara nga DNJF gjatë muajit Tetor 2022, rezulton se nga **72 vendime gjyqësore** në total me objekt kërkesën për ndihmën juridike, **58** prej tyre janë çështje civile, **10** janë çështje administrative, dhe **4** është çështje penale.

Këto të dhëna paraqiten në formë tabelare si vijon:

Të dhëna statistikore sipas natyrës së çështjes gjyqësore që kërkohet ndihma TETOR 2022		
<i>Lloji i çështjes</i>	<i>Numri i kërkuesve</i>	<i>Komente / të tjera</i>
Çështje civile (<i>pronësie, pjestim pasurie, vjetërsi pune</i>)	58	<i>1. Në vijimësi të trendit të zakonshëm evidentohet që në pjesën dërrmuese ndihma juridike kërkohet për çështje civile. 2. Krahasimisht evidentohet një rritje e e çështjeve administrative.</i>
Penale	4	
Administrative	10	
N/A	0	
<u>TOTALI = 72 Vendime Gjyqësore</u>		

6. Të dhëna statistikore: Sipas gjykatave që ka dhënë vendimin.

Nga të dhënat e administruara nga DNJF gjatë muajit Tetor 2022, rezulton se nga **72 vendime gjyqësore** në total me objekt ndihmën juridike, **shumica i përkasin** Gjykatave të Rretheve Gjyqësore dhe **një pjesë e vendimeve** është dhënë nga Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë.

Këto të dhëna paraqiten në formë tabelare si vijon:

Të dhëna statistikore sipas gjykatave që kanë dhënë vendimin TETOR 2022			
<i>Gjykata që ka dhënë vendimin me objekt ndihmën juridike</i>	<i>Numri i vendimeve gjyqësore</i>	<i>Komente / të tjera</i>	
Gjykata e Rrethit Gjyqësor	Tiranë	17	<i>1. Në vijimësi të trendit të zakonshëm, numri i vendimeve i përket në pjesën më dërrmuese gjykatave të rrethit krahasimisht me gjykatat administrative. 2. Tërë vendimet gjyqësore për kërkesat mbi ndihmën juridike janë përcjellë nga 12 gjykata të rretheve gjyqësore.</i>
	Durrës	2	
	Elbasan	6	
	Fier	6	
	Gjirokastër	1	
	Tropojë	0	
	Lezhë	5	
	Lushnje	4	

	Berat	1	
	Pogradec	0	
	Vlorë	3	
	Shkodër	4	
	Pukë	6	
	Përmet	2	
	Kavajë	2	
	Kurbin	2	
	Korçë	1	
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë	Durrës	2	
	Korçë	1	
	Vlorë	4	
	Shkodër	2	
	Gjirokastrë	1	
<u>TOTALI =72 Vendime Gjyqësore</u>			

KONKLUZIONE

✚ Sa i përket Ndhmës Juridike parësore

- ✓ Nga rastet e administruara për muajin Tetor 2022, **në total rezultojnë 780 raste** nga të cilat **302 raste janë trajtuar nga Qendrat** e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore; **314 raste janë trajtuar nga Organizatat Jofitimprurëse** të autorizuara nga Ministri i Drejtësisë; **115 raste janë trajtuar nga Platforma juristionline.al** si dhe **49 raste janë trajtuar përmes numrit të gjelbër 08001010**.
- ✓ Muaji Tetor është muaji me numrin më të lartë të rasteve të raportuara për vitin 2022. Vihet re një **rritje e numrit të rasteve të trajtuara nga Qendrat** (*vihet re ndikimi pozitiv që ka patur zbatimi i Kalendarit të Aktiviteteve Ndërgjegjësuere për muajin Shtator dhe Tetor 2022, në referimin e rasteve pranë Qendrave*); një **rritje e numrit të rasteve të raportuara nga Organizatat jofitimprurëse** të autorizuara (*në kushtet kur dhe numri i organizatave jofitimprurëse të autorizuara nga Ministri i Drejtësisë për periudhën 2022-2024 është rritur*) si dhe një **rritje e numrit të rasteve të trajtuara nëpërmjet platformës juristionline dhe numrit të gjelbër**.
- ✓ Sa i përket Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore **qendrat me numrin më të lartë të rasteve të trajtuara** vijojnë të mbeten: **Qendra Tiranë dhe Gjirokastrë**. Qendrat që kanë nevojë për **promovim të shtuar vijon të mbetet Qendra Dibër si dhe Qendrat e reja të hapura rishtazi në Elbasan dhe Berat**.
- ✓ Sa i përket organizatave jofitimprurëse të autorizuara, organizatat me numrin më të lartë të rasteve janë: **QNL, TLAS dhe Vatra** (*organizatë e re e autorizuar nga Ministri i Drejtësisë*).
- ✓ Nga analiza e të dhënave konstatohet se pjesa më e madhe e rasteve të trajtuara janë të natyrës **civile** (47%) pasuar nga çështjet **administrative** (45%) dhe çështjet **penale** (8%). Numri më i madh i përfituesve sipas gjinisë rezultojnë të jenë **femra** (68%) pasuar nga **meshkujt** (32%).
- ✓ Nga analiza e të dhënave konstatohet se ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore kanë trajtuar një numër të konsiderueshëm të rasteve ku përfitues janë **kategoritë me të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme** (58%). Nuk është raportuar asnjë rast nga ana e Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore ku përfitues janë të miturit (*të miturit viktimë apo të miturit në konflikt me ligjin*). Si rrjedhojë, është e domosdoshme zhvillimi i aktiviteteve ndërgjegjësuere të dedikuara për këtë kategori.
- ✓ Së fundmi, sa i përket mënyrës së raportimit të të dhënave konform udhëzimit nr. 1/2019, të Ministrisë të Drejtësisë, vihet re se disa nga organizatat jofitimprurëse të autorizuara nga Ministri i Drejtësisë vijojnë të mos përcjellin të dhënat sipas formatit të kërkuar (*duke mos specifikuar kategoritë e veçanta përfituese të ligjit*). Lidhur me këtë problematikë, i bëjmë thirrje ofruesve të respektojnë elementët e përcaktuar në udhëzimin nr.1, datë 08.03.2019, “*Për miratimin e rregullave dhe procedurave për mbledhjen, plotësimin dhe administrimin e të dhënave të regjistrave*”).

Sa i përket Ndhmës Juridike Dytësore

- ✓ Nga vendimet gjyqësore me objekt ndihmën juridike falas, të administruara nga DNJF për muajin **Tetor 2022, në total rezultojnë 72 vendime** gjyqësore nga të cilat në **67 vendime janë pranuar** kërkesat për ndihmë juridike dhe/ose përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore, **3 vendime janë rrëzuar** kërkesat për ndihmë juridike dhe/ose përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore, si dhe janë pushuar **2** kërkesa për përfitim nga ndihma juridike dytësore dhe/ose përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore.
- ✓ **Lidhur me** kategorinë përfituese nga shërbimi i ndihmës juridike, numrin më të madh të të cilëve e përbën gjinia femërore. (*43 përfitues femra dhe 29 përfitues meshkuj*).
- ✓ Rezulton se nga 72 vendime gjyqësore në total me objekt kërkesën e ndihmës juridike, 48 prej tyre rezultojnë për kërkues që pretendojnë se i përkasin *kategorisë së personave me pasuri dhe të ardhura të pamjaftueshme*, 22 prej tyre rezultojnë nga *kërkues që bëjnë pjesë në kategoritë e veçanta sipas ligjit*, dhe 2 prej tyre të pa specifikuar në vendimin gjyqësor.
- ✓ Nga 72 vendime gjyqësore në total me objekt kërkesën e ndihmës juridike, 6 prej tyre janë kërkesa për dhënien e *ndihmës juridike dytësore* me avokat, 53 prej tyre janë kërkesa për dhënien e *ndihmës juridike dytësore dhe përjashtimin nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore* dhe 13 prej tyre janë kërkesa për *përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore*.
- ✓ Nga të dhënat e administruara nga DNJF gjatë muajit Tetor 2022, rezulton se nga 72 vendime gjyqësore në total me objekt kërkesën për ndihmën juridike, 58 prej tyre janë *çështje civile* (*pronësie, pjestim pasurie, heqje zotësie për të vepruar, vjetërsi pune, caktim kujdestarie*), **10 janë çështje administrative**, dhe **4 janë çështje penale**. (*pronësie, pjestim pasurie, heqje zotësie për të vepruar, vjetërsi pune, caktim kujdestarie*).
- ✓ **Lidhur me Gjykatat që kanë dhënë vendimet me objekt ndihmën juridike dytësore dhe / ose përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore**, rezulton se: për muajin Tetor 2022, **numrin më të madh të vendimeve e ka dhënë dhënë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë**, e pasuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, Fier dhe Pukë. Shumica i përkasin Gjykatave të Rretheve Gjyqësore dhe një pjesë e vendimeve është dhënë nga Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë.

+ Numri i vendimeve gjyqesore të ankimuara nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas për muajin Tetor 2022:

Në total: **3 kërkesa ankimore:**

1. Vendim i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë – F.R
2. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë – L.M
3. Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë – P.P

+ Ankimet e pranuar nga gjykatat e apelit (civil, administrativ) sipas juridiksionit për muajin Tetor 2022:

Për muajin Tetor nuk është njoftuar asnjë pranim/refuzim ankimi nga gjykatat.

+ Kërkesat për ndihmë juridike dytësore të rrëzuara apo të pushuara nga gjykata për muajin Tetor 2022:

Për muajin Tetor 2022 janë **rrëzuar 3 kërkesa për ndihmë juridike:**

1. Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë – F.L
2. Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat – R.T
3. Vendimi i Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë – Q.K

+ Kërkesa për ndreqje gabimi të depozituara në gjykatë për muajin Tetor 2022:

Për muajin Tetor 2022 janë **depozituar në gjykatë 5 kërkesa për ndreqje gabimi:**

1. Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet – E.M
2. Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet – J,B
3. Vendimi i Gjykata Administrative Shkallës së Parë Tiranë – L.Ç
4. Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan – H.Q
5. Vendim I Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet – K.G

+ Kërkesa për ndreqje gabimi të pranuar nga gjykata për muajin Tetor 2022:

Për muajin Tetor 2022 janë **pranuar 3 kërkesa për ndreqje gabimi:**

1. Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër – M.SH
2. Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër – M.S
3. 3 Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë- I.Z

✚ Numri i dosjeve avokatëve/ekspertëve të pranuar për ekzekutim pagese për ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike dytësore/përgjashtimit nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore për muajin Tetor 2022:

20 praktika të trajtuara për muajin Tetor 2022, për të cilat është pranuar ekzekutimi pagesës për ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike dytësore/përgjashtimit nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore

1. E.Bami për qytetarin përfitues (B.T)
2. A.Garipi për qytetarin përfitues (E.Y)
3. I.Grazhdani për qytetarin përfitues (A.SH)
4. D. Luka për qytetarin përfitues (J.M)
5. P. Jaku për qytetarin përfitues (F.L)
6. I.Grazhdani për qytetarin përfitues (A.R)
7. A.Ymeri për qytetarin përfitues (B.D)
8. E.Shpata për qytetarin përfitues (B.LL)
9. K. Doçaj për qytetarin përfitues (M.H)
10. P.Miloti për qytetarin përfitues (J.S)
11. A.Garipi për qytetarin përfitues (M.B)
12. A.Garipi për qytetarin përfitues (D.C)
13. B.Frroku për qytetarin përfitues (B.K)
14. L.Vathaj për qytetarin përfitues (N.B)
15. V.Bardhushi për qytetarin përfitues (A.B)
16. E. Mirashaj për qytetarin përfitues (E.H)
17. I.Tivari për qytetarin përfitues (R.K)
18. P.Miloti për qytetarin përfitues (M.D)
19. A.Rrelli për qytetarin përfitues (Y.T)
20. M.Derti për qytetarin përfitues (V.GJ)

✚ Numri i dosjeve avokatëve/ekspertëve të refuzuara për ekzekutim pagese për ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike dytësore/përgjashtimit nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore për muajin Tetor 2022:

1 praktikë e trajtuar për muajin Tetor 2022, për të cilën është refuzuar ekzekutimi pagesës për ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike dytësore/përgjashtimit nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore: M.Derti për qytetarin përfitues (V.GJ) (praktika nr. 2)

INFORMACION MBI PAGESAT E PËRFAQËSIMIT TË AVOKATËVE TË NDIHMËS JURIDIKE DYTËSORE SI DHE SHPENZIMET GJYQËSORE TË LIKUJDUARA Janar – Tetor 2022

- Në total gjatë muajit **Tetor 2022** janë likujduar **35 vendime** gjyqësore me vlerë totale prej **1,266,200 lekë**
- Në total për periudhën **Janar – Tetor 2022** janë likujduar **217 vendime** gjyqësore me vlerë totale prej **7,448,940 lekë**.

Vlere	2022			Sasi	2022		
	Avokate	Eksperte	Gjykata		Avokate	Eksperte	Gjykata
Janar	80.000	40.000	-	Janar	2	1	-
Shkurt	335.000	385.000	-	Shkurt	9	10	-
Mars	330.000	20.000	-	Mars	10	1	-
Prill	195.000	40.000	-	Prill	7	1	-
Maj	717.500	255.000	-	Maj	21	7	-
Qershor	786.000	125.000	-	Qershor	23	4	-
Korrik	366.000	235.000	-	Korrik	10	6	-
Gusht	980.000	515.000	15.240	Gusht	27	15	5
Shtator	220.000	540.000	3.000	Shtator	8	14	1
Tetor	930.000	333.000	3.200	Tetor	25	9	1
TOTAL	4.939.500	2.488.000	21.440		142	68	7

NDIHMA JURIDIKE PARËSORE JANAR- TETOR 2022 *Total Ndhma Juridike Parësore: 6209 raste të raportuara*

Muaji	Qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore	Organizatat jofitimprurëse të autorizuara	Klinikat e Ligjit pranë IAL	Platforma juristonline	Numri i gjelbër	Total
Janar	296	224	0	123	24	667
Shkurt	276	236	0	126	20	658
Mars	251	221	0	127	20	619
Prill	259	197	0	151	15	622
Maj	258	235	0	126	22	621
Qershor	255	214	0	114	55	638
Korrik	218	155	0	96	17	486
Gusht	164	163	0	87	36	450
Shtator	286	252	0	106	24	668
Tetor	302	314	0	115	49	780
Nentor						
Dhjetor						
Total	2565	2211	0	1171	282	6209

NDIHMA JURIDIKE DYTËSORE JANAR- TETOR 2022

Vendime Gjyqësore me Objekt Ndihmën Juridike

JANAR – TETOR 2022

Totali i Vendimeve Gjyqësore = 884 vendime

Janar	61
Shkurt	91
Mars	56
Prill	101
Maj	185
Qershor	124
Korrik	71
Tetor	19
Shtator	104
Tetor	72
Nentor	
Dhjetor	
Total	884 vendime gjyqesore te administruara

